



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 77, DATË 03.09.2020

MBI

**NDRYSHIMET E NDODHURA NË STRUKTURËN E PRONËSISË SË  
SHOQËRISË "HOUSE OF ARTS RADIO TELEVISION" SH.P.K., LICENCUAR  
PËR SUBJEKTIN AUDIO PRIVAT VENDOR "HOUSE OF ARTS RADIO"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve me:

Kërkues: Shoqëria "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k.

Objekt: Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat vendor "House of Arts Radio"

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 65, pika 3 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**VËREN SE:**

Shoqëria "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., është licencuar me vendimin nr. 174, datë 03.09.2003, për subjektin "Radio House of Arts". Me vendimet nr. 137, datë 08.06.2016 dhe nr. 123, datë 30.09.2019, AMA ka rinovuar licencën e subjektit. Me vendimin nr. 35, datë 29.03.2017, AMA ka vendosur ndryshimin e emrit të subjektit nga "Galaxy Radio" në "House of Arts Radio". Afati i vlefshmërisë së licencës përfundon në datën 08.06.2024.

Me shkresën nr. 1986 prot., të datës 16.07.2020, të paraqitur pranë AMA-s, subjekti ka depozituar Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e shoqërisë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., licencuar për subjektin audio "House of Arts Radio".

Nga shqyrtimi i këtij dokumenti rezulton së është ndryshuar struktura e pronësisë së shoqërisë, duke patur si ortak të vetëm me 100% të kuotave zj. Elona Jegeni, ndërkohë që struktura e miratuar nga AMA është znj. Elida Heba me 100% të kuotave.

Në vijim të njoftimit të mësipërm, AMA, me shkresën nr. 1986/1 prot. datë 30.07.2020, ka kërkuar nga shoqëria "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., plotësimin e njoftimit lidhur me ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë duke kërkuar depozitimin e:

- Vërtetimit të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të zj. Elona Jegeni (dëshminë e penalitetit);
- Deklaratës noteriale mbi kuotat/aksionet që zj. Elona Jegeni, mund të zotërojnë në subjekte të tjerë audio dhe/ose audiovizivë;
- Kontratës së shitjes së kuotave;
- Dokumentacionit zyrtar mbi vetitë dhe ekspertizën e organeve drejtuese të shoqërisë suaj;
- Vërtetimit mbi eksperiencat e punës të ortakut të ri të shoqërisë zj. Elona Jegeni, vërtetimit prej institucioneve tatimore dhe/ose sigurimeve shoqërore mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat etj, të derdhura në favor të saj;
- Të dhënave zyrtare mbi burimet financiare të ortakut të ri të shoqërisë, zj. Elona Jegeni si dhe raportit të detajuar mbi aspektet e funksionimit ekonomik të shoqërisë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., përfshirë këtu parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat për kohëzgjatjen e licencës;
- Listës emërore të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe *Curriculum Vitae* të tyre, nëse ky i fundit do të pësojë ndryshime;
- *Curriculum Vitae* të ortakut të ri të shoqërisë zj. Elona Jegeni, (të firmosur).

Në zbatim të vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 "Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive", subjekti ka kryer pagesën për ndryshimet e kryera në strukturën e pronësisë, në masën 50.000 lekë, në datën 19.08.2020.

Në vijim të njoftimit të sipërcituar, subjekti me shkresën nr. 1986/2 prot., datë 24.08.2020, ka depozituar dokumentacionin justifikues si më poshtë:

1. Shkresën përcjellëse, në të cilën ka informuar mbi eksperiencat e saj të punës dhe bashkëpunimin me radio që prej fillimit të aktivitetit radiofonik, duke bërë me dije se bordi drejtues dhe stafi, pavarësisht ndryshimit të ortakut, do të mbetet i njëjti.
2. Vërtetimin e datës 23.08.2020, nga zj. Anita Ylli nga i cili rezulton se zj. Elona Jegeni është e punësuar në shoqërinë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., që prej vitit 2002, me profesionin asistente e ortakut të vetëm, për të vijuar më tej me pozicionin, specialiste marketing.
3. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore me nr. 11, datë 18.08.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nga i cili rezulton se zj. Elona Jegeni (Vovoda), është e padënuar.
4. Deklaratën noteriale me nr. 1582 rep., dhe nr. 713 kol., të datës 18.08.2020, në të cilën zj. Elona Jegeni deklaron se nuk disponon asnjë licencë tjetër kombëtare apo lokale si dhe nuk ka aksione në ndonjë subjekt tjetër audio ose audioviziv.
5. Kontratën e shitjes së kuotave të datës 13.07.2020, me nr. 1143 rep., dhe nr. 488 kol., të lidhur ndërmjet ortakut ekzistues, në cilësinë e shitësit dhe zj. Elona Jegeni në cilësinë e

blerësit, me objekt kalimin e 100% të kuotave që zotëron në shoqërinë “House of Arts Radio Televizion” sh.p.k.

Sipas kësaj kontrate, likuidimi i çmimit të shitjes prej 30,000,000 lekë (çmimi i 100% kuoteve) do të paguhet nga pala blerëse brenda vitit 2025. Në rast se pala nuk shlyen çmimin e blerjes, palët do të kthehen në gjendjen fillestare.

6. Vërtetimin me nr. T02728444, të datës 17.08.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për zj. Elona Jegeni për periudhën janar 2019-korrik 2020.
7. Parashikimin e planit ekonomik-financiar për periudhën 2020-2023.

Subjekti po ashtu ka ndryshuar edhe administratorin e shoqërisë nga zj. Elida Heba në zj. Anita Ylli.

Në nenin 65, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë: të ndryshuar, parashikohet se: “*Subjekti i licencuar duhet të njoftojë AMA-n për çdo ndryshim në të dhënat e shoqërisë së licencuar brenda një afati 30-ditor nga bërja e ndryshimeve.*”

Në rastin konkret rezulton se, shoqëria “House of Arts Radio Televizion” sh.p.k., nuk ka hyrë në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave të jetë veprimtaria radiotelevizive e licencuar, por ka ndryshuar përkatësia pronësore.

Duke qenë se kontrata e shitjes së kuotave është me kusht, AMA vlerëson se në vendim duhet të parashikohet detyrimi që shoqëria e licencuar të njoftojë autoritetin në mënyrë periodike mbi respektimin e afateve për likuidimin e çmimit të shitjes prej 30,000,000 lekë (çmimi i 100% i kuotave) i cili do të paguhet nga pala blerëse brenda vitit 2025. Sipas nenit 102 të Kodit të Procedurave Administrative: “1. *Një akt administrativ dobiprurës mund të shoqërohet me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme shtesë: ... b) një datë ose një periudhë kohore, në të cilën një e drejtë, një përfitim ose barrë, përkatësisht do të fillojë, përfundojë ose zgjasë; c) një rezervë nga ana e organit publik sa i përket shfuqizimit; dhe/ose ç) një kusht shtesë që kërkon që përfituesi të kryejë, të ndalojë një veprim të caktuar ose të lejojë një veprim të caktuar...*”.

Sa më sipër, kërkesa e subjektit për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë është e mbështetur në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet,

## PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 65, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

## V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “House of Arts Radio Televizion” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Radio House of Arts”, për kalimin e kuotave të shoqërisë tek znj. Elona Jegeni, e cila shndërrohet në ortakun e vetëm të subjektit me 100% të kuotave.

2. Shoqëria "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat "House of Arts Radio", ka detyrimin të njoftojë AMA-n, në mënyrë periodike mbi respektimin e afateve për likuidimin e çmimit të shitjes së kuotave të shoqërisë.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**

